

02-06-2023

Nr. 3541
publikon ofertën për pozitat e mëposhtme:

Shpallje Publike

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës, Seksionin V Pikën 3(c) të Rregullores së KEK-ut Sha dhe nevojave të paraqitura për plotësimin disa vendeve të lira të punës në Divizionet e KEK-ut, Divizioni i Burimeve Njerëzore, më 02.06.2023 publikon ofertën për pozitat e mëposhtme:

Inxhinier të Elektroenergjetikes (13 kryerës)

Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:

Bartësi i vendit të punës përgjigjet në të gjitha punët inxhinierike të elektroteknikës që kryhen në Departament, me qëllim që të ti dalin në pah cilësitë e tij profesionale në bazë të së cilave më vonë do të emërohet në vend adekuat të punës .

Merr punët nga Udhëheqësi i Njësisë ku është i sistemuar dhe përpunon UP me ndërlikueshmëri të lartë dhe të mesme tekniko teknologjike në bashkëpunim të ngushtë me inxhinierin përgjegjës.

Bashkëpunon edhe me kolegët e tjerë të Departamentit për realizimin me sukses të punëve që ka marr për sipër.

Përcjell dhe merr pjesë në hartimin e listave defektuese gjithnjë në bashkëpunim të ngushtë me inxhinierin përgjegjës.

Obligohet për zbatimin e metodave të avancuara tekniko teknologjike për aq sa lejojnë kushtet ekzistuese.

Punon dhe përpunon dokumentacionin teknik në formë elektronike ("Auto CAD).

Mban përgjegjësi për punët e kryera nga ana e tij.

Është i obliguar ta ruaj sekretin afarist.

Zbaton dhe respekton rregullat e mbrojtjes dhe sigurisë në punë sipas rregullave dhe ligjit në fuqi .

I kryen dhe i zbaton të gjitha detyrat dhe obligimet të tjera që i urdhërohen nga eprori i tij.

Kërkesat profesionale/ Kualifikimet

- Duhet të ketë Përgatitje Superiore Profesionale nga lëmia e Elektroteknikës dega ; Energjetikes se paku bachelor, Master Energjetikes apo inxhinier i diplomuar i Energjetikes,
- Perparesi niveli inxhinier i diplomuar Energjetikes /apo Master Energjetikes
- Perparesi me pervoj pune ne udheheqje te puneve qe kane te bejne me drejtimin Energjetikes
- Të ketë aftësi për punë ekipore në mënyrë të pavarur,
- Të ketë njohuri për punë në kompjuter,dhe njohje te gjuhës angleze

Inxhinier të Elektronikes

(9 kryerës)

Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:

Bartësi i vendit të punës kyçet në të gjitha punët inxhinierike të elektroteknikës që kryhen në Departament, me qëllim që të ti dalin në pah cilësitë e tij profesionale në bazë të së cilave më vonë do të emërohet në vend adekuat të punës .

Merr punët nga Udhëheqësi i Njësisë ku është i sistemuar dhe përpunon UP me ndërlikueshmëri të lartë dhe të mesme tekniko teknologjike në bashkëpunim të ngushtë me inxhinierin përgjegjës.

Bashkëpunon edhe me kolegët e tjerë të Departamentit për realizimin me sukses të punëve që ka marr për sipër.

Përcjell dhe merr pjesë në hartimin e listave defektuese gjithnjë në bashkëpunim të ngushtë me inxhinierin përgjegjës.

Obligohet për zbatimin e metodave të avancuara tekniko teknologjike për aq sa lejojnë kushtet ekzistuese.

Mban përgjegjësi për punët e kryera nga ana e tij.

Është i obliguar ta ruaj sekretin afarist.

Zbaton dhe respekton rregullat e mbrojtjes dhe sigurisë në punë sipas rregullave dhe ligjit në fuqi .

I kryen dhe i zbaton të gjitha detyrat dhe obligimet të tjera që i urdhërohen nga eprori i tij

Kërkesat profesionale/ Kualifikimet

- Duhet të ketë Përgatitje Superiore Profesionale nga lëmia e Elektroteknikës dega ; elektronik dhe automatik se paku bachelor, Master elektronik dhe automatik apo inxhinier i diplomuar i elektronik dhe automatik .
- Perparesi niveli inxhinier i diplomuar elektronik automatik /apo Master elektronik automatik .
- Perparesi me pervoj pune ne udheheqje te puneve qe kane te bejne me drejtimin elektronik automatik.
- Të ketë aftësi për punë ekipore në mënyrë të pavarur,
- Te ketë njohuri për punë në kompjuter njohje e programeve te PLC,dhe njohje te gjuhës angleze

KEK-u fton të gjithë të interesuarit, ne veçanti kandidatet femra dhe nga komunitetet pakicë, të aplikojnë për pozitat e publikuara

Për me shume informata për pozitat e lartpërmendura vizitoni ueb faqen: www.kek-energy.com, ikona 'Shpallje' dhe mund ta shkarkoni Aplikacionin për pozitën që dëshironi të aplikoni. Aplikacioni i plotësuar bashkë me të dhënat tjera dërgohet përmes aplikimit online në vegzën përkatëse.

Vërejtje: Aplikacioni të jetë i kompletuar dhe mund të aplikohet vetëm një herë. Përveç Aplikacionit duhet të dorëzoni **diplomën e bachelorit , masterit apo inxhinier i diplomuar**. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk do të pranohen ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen. Aplikantët të cilët nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës duhet të kenë leje qëndrimin në Kosovë. Kontrata e punës për të punësuarit për pozitën e zgjedhura do të jetë 1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj. Kandidatët e suksesshëm do të sistemohen në pozitat e lira sipas kërkesave nga divizionet operative të KEK-ut sipas kësaj shpallje. Ata/ato do të sistemohen në vendin e punës me kontratën 1 vjeçare me mundësi vazhdimi dhe nuk mund të ri sistemohen për 3 (tre) vite nga dita e kontratës së pare. Testimi do të bëhet në formë elektronike ashtu që vlerësimi do të jetë automatik. Procesi i testimit dhe intervistimit për kandidatët e Suksesshëm me qëllim të transparencës do të monitorohet nga kamerat.

Prishtinë, 02.06.2023

Data e aplikimit deri më 16.06.2023 ora 16:00

Divizioni i Burimeve Njerëzore

